REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 93/20
Datë/Datum. 10.02.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-19-5919-2-3-6**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Kryerja e shërbimeve të transportit me mjete bartëse marimangë për territorin e Komunës së Prizrenit**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.SH. "EURO AG"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Beteja e Kabashit 204
(Adresa)

Prizren *(Vendi)* **20000** *(Kodi postar)*

044/191-329 *(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

GËZIM GASHI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntsh.euroag@gmail.com
(Adresa elektronike)

07.02.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

NDËRMARRJA TRANSPORTUESE SHËRBYESE TRANSPORTER SERVICE COMPANY EURO A.G. Prizren 1.2.3.4

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, Data: 20.01.2020, Kërkesa për Rishqyrtim, Data: 23.01.2020 dhe VENDIMI Mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Data: 05.02.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po				**Jo**	X	

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				Jo	

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, Data: 20.01.2020, Kërkesa për Rishqyrtim, Data: 23.01.2020 dhe VENDIMI Mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Data: 05.02.2020 që i keni të bashkangjitura.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi,
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 64 – Dëshmitë e kërkesave
Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 20.01.2020, kemi pranuar Letrën Standarde të Tenderuesit të pasuksesshëm, në të cilën Autoritet Kontaktues i ka cekur arsyet që nuk qe e suksesshme oferta jonë për shkak të Çmimit dhe pas qasjes në dokumentacionin zyrtar, të ofertës së dorëzuar me rastin e tenderimit te OE "Dreni - A" SH.P.K. kemi hasur në këto parregullsi:

1. Në vendimin e OSHP-së me numër PSH.nr.810/19 paneli vlerësues vjen në përfundim si në vijim citoj:

"Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënien e kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët."

dhe e obligon AK si në vijim citoj:
"Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes dhe njoftimit për kontratë."

Autoritet kontraktues nuk u është përmbajt Vendimit të OSHP-së dhe njëherit ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënien e kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët dhe ka shpall fitues të njëjtin operator ekonomik përsëri.

2. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e tenderit të formuar nga AK kanë dal në verifikim të pronës dhe vendparkingut të OE të shpallur fitues. Sipas procesverbalit të mbajtur nga vetë anëtarët, OE i shpallur fitues **nuk e ka të mbuluar me kamera dhe ndriçim hapësirën e parkingut**, pra OE nuk e ka plotësuar kriterin që parkingu duhet të jetë e rrethuar me ndriçim të përhershëm dhe me kamera funksionale 24 orë.
   - Komisioni verifikues nuk e ka verifikuar vendin e daljes në terren me atë të prezantuar nga OE me rastin e konkurrimit, por vetëm ka shkuar aty ku ka dashur OE i shpallu fitues.
   - OE i shpallur fitues me rastin e tenderimit ka ofruar tjetër parcelë, ndërsa Anëtarët e Komisionit i ka dërguar tek një parcelë tjetër për verifikim.
   - OE duhet të ofrojë kopjen e planit të shtypur në letër dhe të vulosur nga Agjensioni Kadastral në Prizren, dhe pastaj të verifikohet pjesa e parkingut.
   - OE i shpallur fitues duhet të prezantoj Kopjen e Planit të parcelës **5211-1** ashtu si ka ofertuar, jo të parcelave 5211-01 dhe 5211-0. Kopja e planit për parcelën 5211-1 me sipërfaqe prej 6676m² nuk ekziston fare, ndërsa sipërfaqja e parcelës 5211-01 është 7844m² dhe e 5211-0 është 5073m².

Anëtarët e Komisionit të verifikimit janë vënë në lajthitje nga përfaqësuesit e OE të shpallur fitues duke i dërguar ata tek një parcelë tjetër nga ajo që ka tenderuar. Autoritet Kontraktues duhet ta kërkoj nga OE **Kopjen e Planit** të parcelës 5211-1 dhe nëse OE i shpallur fitues nuk mund ta dëshmoj, AK të kërkoj nga OSHP që kompaninë Dreni-A SH.P.K. **ta diskualifikojë nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare sipas Ligjit të LPP-së, Nenit 99 Pika 2 për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar**. Bashkangjitur keni konstatimin e Kompanisë Gjeodezike që parcela me numër 5211-1 mungon pjesa grafike, pra parcela me numër 5211-1 nuk ekziston në regjistrat zyrtar.

Përveç këtyre gjetjeve, AK me dërgimin e komisionit verifikues për ta verifikuar parkingun e kompanisë Dreni-A SH.P.K. e keni shkel nenin 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënien e kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sepse kompania Dreni-A SH.P.K. me rastin e tenderimit ka pranuar se nuk e ka të plotësuar kriterin për parkingun dhe ka ofruar deklaratë që do ta plotësojmë këtë kriter për **Rrethojë** dhe **Kamera** ndërsa kriterin e **Ndriçimit** nuk e përmend fare që do ta rregulloj.

AK në njërën anë ka kërkuar që ky kriter duhet të plotësohet me rastin e tenderimit ndërsa në anën tjetër e ka pranuar DEKLARATËN nga OE i propozuar për kontratë se këtë kriter jemi të gatshëm ta përmbushim RRETHOJEN dhe VËZHGIMIN E KAMERAVE, ndërsa nuk e ka shpreh gatishmërinë ta përmbushin dhe NDRIÇIMIN siç është kërkuar me tender, dhe me këtë deklaratë e ka pranuar si kriter të plotësuar. OE i propozuar për kontratë me anë të Deklaratës e pranon që me rastin e tenderimit nuk e ka përmbush kriterin.

3. Në bazë të Neni 61, Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Pika e këtij neni të LPP-së, citoj: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

- AK në NJOFTIM PËR KONTRATË të datës **07.08.2019**, Sipas **Nenit II.2)** SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS citoj: **Do të barten të gjitha automjetet e parkuara gabimisht ose të lëna në defekt brenda territorit të Komunës së Prizrenit**

- OE i propozuar për kontratë ka ofruar sqarim jo të vlefshëm sepse OE ka ofruar sqarim vetëm në rast të "**Sekuestrimit apo Konfiskimit**" nga **Policia** e jo automjetet e **Parkuara Gabimisht** apo **Automjetet e lëna në defekt (aksidentuara)**. Në njoftimin për kontratë askund nuk përmendet fjala Sekuestrim apo Konfiskim.

- Ndonëse tenderi është shpallur nga AK K. Prizren, OE i shpallur fitues ka dhënë sqarim bazuar në rregulloren e policisë ndërsa Çmimorja e lëshuar nga Drejtoria për Komunikacion dhe Lidhje e ka shumë mirë të sqarua çmimet e zhvendosjes me merimangë brenda dhe jashtë qytetit ku neri me Njoftimin për Kontratë është punuar sipas kësaj çmimore. Bashkangjitur sqarimi OE dhe Çmimorja nga AK.

Megjithëse çmimi i ofruar është i papranueshëm 100% nën çmimin e udhëzimit administrativ, sqarimi i ofruar nga OE i shpallur fitues nuk është i duhuri, OE i shpallur

fitues e ka ndryshuar komplet përmbajtjen esenciale të fjalëve Parkuar gabimisht, Automjete të lëna në defekt dhe i ka zëvendësuar ato me Sekuestrim apo Konfiskim nga Policia. Andaj ne si OE ofertues kërkojmë nga AK që në bazë të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët , Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) . Pika 4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.

4. Sipas LPP-së, Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, Paragrafi 6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur këtë Nen të LPP-së duke marrë vendim vetëm pas 9 dite ditë pune. AK ka ndryshuar datat e vendimit, publikimit dhe kërkesës nuk përputhen fare në vendim sa që ka shpikur datë të re 32.01.2020.

Konkluzion:
Krejt ne fund kërkojmë nga OSHP që ta anulon vendimin e AK sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik e Ligjit për Prokurim Publik, konkretisht e Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi, Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës, Neni 64 – Dëshmitë e kërkesave, Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale dhe Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve te LPP-se.

Pretendimi jonë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen në dosjen e tenderit dhe përgjigjet/sqarimet të dorëzuar nga OE i propozuar për kontratë e të cilat i potencuam edhe më larte, prandaj kërkojmë që Vendimi për shpalljen e fituesit të këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet Ankesa jonë dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Fitimi nga vlera e realizimit të shërbimeve që është 50% e shërbimeve totale si dhe

shpenzime tjera lidhur me përgatitjen e aktivitetit të prokurimit, Kërkesat për Rivlerësim në AK dhe Ankesat në OSHP.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "NJOFTIM PËR KONTRATË".*
b) *një kopje të publikimit për "NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES".*
c) *një kopje të "Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm".*
d) *Deklarata e OE të shpallur fitues për përmbushjen e kritereve.*
e) *Kopja e Planit (skica) dhe konstatimi se parcela me nr,5211-1 mungon në elaboratin kadastral.*
f) *Vendimi i AK mbi refuzimin e ankesës*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*